



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2022

**VENDIM**

**Nr. 198, datë 27.05.2022**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka dhe Xhevdet Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Neni 100/2 dhe 84 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 242 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkesues: {...} etj.; Të pandehur: {...}, etj; Akuza: Neni 283/a/2 e 22 i Kodit Penal; Objekti: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Eglantina Mikani, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkesues: {...} etj.; Të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 250, 259/1, 25, 244/1 të Kodit Penal; Objekti: Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Kryerja e veprës penale të parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka dhe Hasan Selimi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...} etj.; Akuza: Vepra penale të parashikuara në nenin 283/2 dhe nenin 284/2 të Kodit Penal; Objekti: Kërkesë për gjykimin e procedimit penal me nr.51, viti 2001.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Sonila Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehurit: {...}, {...}, etj.; Akuza: Vepra penale të parashikuara në nenin 102/2 dhe nenin 117/1 të Kodit Penal; Objekti: Dërgimin e çështjes në gjyq.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Erlanda Agaj (relatore), Alfred Konomi dhe Sonila Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: Vepra penale të parashikuara në nenin 300 dhe nenin 302/1 të Kodit Penal; Objekti: Kërkesë për gjykim.

## **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Paditës {...} ; Të paditur: {...}, {...}, {...}; Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5 datë 25.06.1999 në emër të {...}, etj.

2. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi dhe Etleva Gjamo, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: 1. Detyrimin e të paditurit {...}, të përmbushë detyrimin në shumën 4.911.772 lekë, në bazë të kontratës për punë publike, me nr 1067 prot., datë 26.04.2019; 2. Detyrimin e të paditurit {...}, të përmbushë detyrimin në shumën 4.931.370 lekë në bazë të kontratës për punë publike me nr.1202 prot., datë 10.05.2019.

3. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Etleva Gjamo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen administrative me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Kundërshtoj vendimin Nr.573 datë 01.02.2016 të {...}, të rishqyrtimit të pensionit vetëm përsa i përket datës së fillimit të pagesës së shtesës së pensionit e cila duhet të fillojë nga data e paraqitjes së kërkesës për akordimin e pensionit me nr.343 datë 01.04.2013, në bazë të shkresës së ISSH Nr.5596 datë 13.10.2010.

4. Gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi dhe Etleva Gjamo, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: Detyrimi i palës së paditur për pagimin e shumës prej 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro sipas faturës tatimore shitjeje nr.33 të datës 30.06.2015, së bashku me kamatat e arrira deri në momentin e ekzekutimit të vendimit.

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale të “Mospagimit të taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të Pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: “Vjedhje me dhunë e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 137 dhe 25 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës {...} {...}, {...}; I paditur: {...} ; Persona të tretë: {...}, {...}; Objekti: Ushtrimi i të drejtës së takimit të gjyshërve.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**